

VENDIM
Nr. 864, datë 27.12.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURËN E TRAJTIMIT TË
KËRKESAVE PËR SHËRBIME KADASTRALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 29, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim miratimin e rregullave për procedurën e trajtimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kërkesave për shërbime kadastrale që paraqiten nga pronari i pasurisë së paluajtshme, titullari i një të drejte reale apo personi fizik/juridik, që ka një interes të ligjshëm mbi një pasuri të paluajtshme.

2. Kërkesa për shërbime kadastrale bëhet nga kërkuesi, vetë apo nëpërmjet përfaqësuesit, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga noteri, në respektim të shkronjës “k”, të pikës 1, të nenit 63, të ligjit nr.110/2018, “Për noterinë”.

3. “Përdorues i brendshëm i bazës shtetërore të të dhënave kadastrale” (ALBSCAD), është punonjësi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që ka të drejtën e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së të dhënave të pasurive të paluajtshme, në përputhje me vendimin nr.1179, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave”.

II. RREGULLAT E PROCEDURËS SË TRAJTIMIT TE KERKESAVE

1. Kërkesa për shërbime kadastrale pranohet vetëm *on-line*, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” dhe sistemeve elektronike të regjistruara si baza të të dhënave shtetërore.

2. Me dërgimin e kërkesës për shërbime kadastrale, ajo regjistrohet në mënyrë automatike në regjistrin elektronik të kërkesave dhe trajtohet nga drejtoria/zyra vendore e ASHK-së, sipas kompetencave të përdoruesve të brendshëm të bazës shtetërore të të dhënave kadastrale (ALBSCAD).

3. Trajtimi i kërkesave për shërbime kadastrale bëhet në mënyrë kronologjike, dhe llogaritja e afateve për marrjen e këtyre shërbimeve fillon nga e nesërmja e ditës së konfirmimit bankar të pagesës së tarifës së shërbimit. Përfshihen këtu:

a) Shërbimet kadastrale që gjenerohen në mënyrë automatike nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale (ALBSCAD);

b) Shërbimet që ofrohen për institucionet shtetërore me paspagim, sipas vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar;

c) Shërbimet për të cilat dokumentacioni shoqëruar përcillet nëpërmjet shërbimit postar.

4. Për kërkesat për shërbime kadastrale, për të cilat është njoftuar subjekti për kryerjen e pagesës së tarifës së shërbimit dhe nuk është konfirmuar kryerja e saj, ASHK-ja njofton subjektin për mosfrimin e shërbimit.

5. Në varësi të llojit të shërbimit kadastral, kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor. Ky i fundit ngarkohet me nënshkrim elektronik kur përcillet nga institucionet shtetërore dhe si kopje elektronike kur përcillet nga kërkuesi, vetë apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij. Kur dokumentacioni shoqëruar ngarkohet vetëm si kopje elektronike, ai përcillet edhe nëpërmjet shërbimit postar pranë drejtorisë/zyrës vendore të ASHK-së.

Menjëherë me administrimin e dokumentacionit nëpërmjet shërbimit postar, ai i nënshtrohet digjitalizimit të plotë nga drejtoria/zyra vendore e ASHK-së dhe, vetëm pas këtij procesi, ajo ka të drejtë të trajtojë kërkesën për shërbim kadastral në përputhje me afatet ligjore.

6. Drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së ofrojnë vetëm në mënyrë digjitale shërbimet kadastrale për të cilat është kryer konfirmimi i pagesës së tarifës, sipas afateve të miratuara. Ato pranojnë kërkesën duke dhënë shërbimin kadastral ose kërkojnë plotësimin e mangësive të dokumentacionit, sipas pikës 26, të vendimit nr.782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Modeli i kërkesës për shërbime kadastrale, në përputhje me pikën 1, të nenit 29, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Drejtori i Përgjithshëm miraton me udhëzim procedurat standarde të veprimeve me regjistrin elektronik të kërkesave.

2. Shlyerja e pagesave të tarifave për shërbime kadastrale bëhet në llogarinë bankare të drejtorisë/zyrës vendore përkatëse të ASHK-së, ku kërkohet shërbimi, sipas vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.

3. Vendimi nr. 376, datë 6.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama